**Njoftim për aplikim për licencim**

nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë se shoqëria “3X ENERGY” shpk, ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 70 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3268, fshati Saver, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier, duke përfshirë dhe veprat ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.

Në mbledhjen e datës 10.08.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesën për licencim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve (nga data 11.08.2026 deri më 09.09.2026), pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.